



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 83/1 prot.

Tiranë më 19.1.2018

Lënda: Mendim mbi projekt marrëveshjet e ripranimit dhe protokollet e zbatimit me Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.6144/10, datë 16.01.2018, projekt marrëveshjet e ripranimit dhe protokollet e zbatimit me Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin në tërësi vlerësohen të hartuara konform ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Vlerësojmë se, në të katërt projekt marrëveshjet, në përshtatje me terminologjinë e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gërma (f) e nenit 16, të riformulohet si vijon:

"(f) Si autoriteti komunikues ashtu dhe autoriteti marrës do të ndër marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi."

Gjithashtu, sugjerojmë që pas gërmës (i) të nenit 16, të shtohet një gërmë (j) me këtë përmbajtje:

"(j) Autoritetet komunikuese dhe marrëse që vihen në dijeni me të dhënat personale gjatë përpunimit të tyre detyrohen të ruajnë konfidencialitetin."

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

